



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E BUJQËSISË, UJITJES DHE ADMINISTRIMIT TË PYJEVE
SEKTORI I MENAXHIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr 2349 prot.

Lezhë, më: 18.02 2026

PROJEKT-V E N D I M

NR. _____, Datë 18.02, 2026

PËR

DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROCEDURAVE PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR TË SIPËRFAQES PYJORE NË PRONËSI PRIVATE, PËR NDËRTIM OBJEKTI ME FUNKSION BANIMI DHE SHËRBIME ME 1-6 KATE MBI TOKË DHE 1-3 KATE NËN TOKË NGA SHOQËRIA "DUKAGJINI GROUP" SHPK

Bazuar në Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen vendore", Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", Ligjin nr. 107/2014 datë 31.7.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", në Ligjin nr. 57/2020 datë 30.4.2020 "Për Pyjet", në VKM-në nr.888 datë 27.12.2022 "Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre", VKM-në numër 267 datë 27.04.2023 për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin numër 559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore", VKM-në nr 537 datë 22.09.2021 "Për përcaktimin e kostove të përlllogaritura për pyllëzim kompensues, në rastet e ndryshimit të destinacionit të fondit pyjor", udhëzimin Nr. 1, datë 26.01.2017, të Ministrit Mjedisit, "Për mbajtjen e kadastrës së fondit pyjor dhe kullosor kombëtar" pas shqyrtimit të dokumentacionit, Kryetari i Bashkisë:

PROPOZON:

1. Të shprehë dakortësinë për vijimin e procedurave të heqjes nga fondi pyjor kombëtar sipërfaqen prej **0,2633 ha** pyll në pronësi private, sipas raportit tekniko ekonomik bashkangjitur. Sipërfaqja që do të hiqet nga fondi pyjor privat detajohet si mëposhtë:
 - **0.2633 ha** pyll në pasurinë 1000/85 zona kadastrale 2568, ngastra pyjore 62a, ekonomia pyjore "Mali i Rrencit".

2. Kostoja e rehabilitimit të sipërfaqes pyjore të dëmtuar, jashtë pjesës ku do të ndërtohet objekti, paguhet nga shoqëria “**DUKAGJINI GROUP**”sh.p.k përpara zbardhjes së lejes së ndërtimit, sipas marrëveshjes me Bashkinë Lezhë.
3. Për zbatimin e këtij projekt-vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015.

KRYETARI

Pjerin NDREU



Drejtoria e Bujqësisë

Drejtori: P Gjergji

Përgjegjës: A Palushi

Kopje Nr. 3